

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

Fakulteti Filozofik

Departamenti i Historisë

Ma. Luan TETAJ

EKSPOZE E TEMËS SË DOKTORATËS:

KUVENDET NDËRBALLKANIKE DHE SHQIPTARËT NË SHEKULLIN

XVI - XVII

Metodologjia e trajtimit të temës - në këtë ekspozitë të temës është paraqitur në pika të shkurtra të arriturat e tezës së doktoratës. Trajtimi i kësaj teme përfshinë një periudhë kohore prej dy shekujsh. Studimi nga ky këndvështrim i marrëdhënieve të shteteve ballkanike dhe trevave shqiptare janë të rëndësishme për historiografinë shqiptare. Ky problem nga historiografia shqiptare nuk është trajtuar në tërësi, por i ndarë. Një nga tipet më të rëndësishme kualitative dhe kuantitative është hulumtimi historik i cili përfshinë mbledhjen sistematike dhe vlerësimin objektiv të dhënave që kanë të bëjnë me ngjarjet e kaluara, që na ndihmojnë t'i shpjegojmë ngjarjet e sotme dhe t'i parashikojmë për të ardhmen. Për shkak të specifikës së hulumtimit shkencor dhe historisë në përgjithësi gjatë këtij hulumtimi ka qenë i domosdoshëm hulumtimi nëpër disa faza. Qëllimi themelor i këtij hulumtimi shkencor ka të bëjë me pasqyrimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve të popujve të Ballkanit dhe vendimet që u morën në kuvendet ndërbalkanike. Përgjithësisht mund të themi se historiografia shqiptare apo edhe historiografia e vendeve të rajonit, që lidhet drejtpërdrejt me organizimin e kuvendeve ndërbalkanike, nuk i është kushtuar vëmendja e duhur. Gjatë punës, lënda e botuar arkivore është dashur të mblidhet, të analizohet dhe të krahasohet dhe pastaj të inkorporohen në studimin e këtij punimi. Dokumentet e pabotuara, të botuara dhe literaturën relevante, jemi munduar t'i trajtojmë dhe të afrojmë një ndërlidhje të kuptueshme. Popujt e Ballkanit gjatë shekujve që kemi marrë në shqyrtim, i tejkalon të gjitha interesat e tyre të ngushta dhe u bashkuan rreth një kauze të

përbashkët për çlirimin e Ballkanit nga Perandoria Osmane. Ky ishte parimi kryesor metodologjik që ndoqëm gjatë punës në hulumtimin dhe punimin e temës.

Arsyshmëria e hulumtimit të temës - hulumtimi dhe ndriçimi i një teme të tillë kërkon mbledhjen dhe sintetizimin e materialit të shumtë, duke analizuar dhe krahasuar dhe pastaj duke ardhur në përfundime. Po ashtu, kërkon njohuri të mjaftueshme për historinë e popujve të Ballkanit gjatë shekujve në shqyrtim. Qëllimi themelor i këtij hulumtimi shkencor ka të bëjë me pasqyrimin dhe zhvillimin e kuvendeve shqiptare dhe ndërballkanike gjatë shekujve XVI-XVII, që deri më tani në historiografinë tonë kjo çështje nuk është trajtuar kënaqshëm, por, sigurisht që kuvendet shqiptare dhe ndërballkanike, shtojnë edhe me tutje kërkesën për studime të mëtutjeshme. Për të arritur qëllimin që kemi parashtruar, është dashur të zgjedhim metodën më të mirë të punës e cila do na dërgonte në përfundime sa më objektive. Problemi i punimit si i tillë duhej të jetë i lidhur ngushtë me qasjen teorike, por, edhe me hipotezën dhe me metodat e parashikuara të kërkimit bibliografik. Kemi përzgjedhur metodën e analizës së materialeve historike, duke i vënë në kontekst të rrethanave të kohës.

Burimet - primare janë materialet arkivore si regjistra, kronika etj., të cilat janë burime kryesor, dhe përmes tyre interpretohet dhe shtjellohet tema në fjalë. Përveç burimeve të shkruara historike, mund të shërbejnë edhe legjendat, mitet, tregimet me karakter historik etj. Kurse burimet tjera janë provat mbështetëse për të forcuar supozimet dhe hipotezat shkencore të ngritura lidhur me problemin në fjalë. Këto burime shpesh herë analizohen dhe krahasohen për të ardhur në përfundimet e bazuara në mënyrë shkencore. Materialet më kryesore për punimin e temës së disertacionit, padyshim i përkasin burimeve të mbledhura nga një brez i tërë studiuesish. Këto burime materiale ndahen në burime të pabotuara dhe burime të botuara, që lënda e tyre është nxjerrë nga arkivat e Romës, Venedikut, Napolit, Spanjës, Austrisë, Kroacisë, Malit të Zi, Serbisë etj. Pjesa më e madhe e burimeve të nxjerra nga këto arkiva janë të botuara, por kemi edhe një mori dokumentesh që nuk janë të botuara.

Përmbajtja e trajtuar në temë - ky punim përfaqëson një punë të plotë dhe të dokumentuar mirë për *“Kuvendet ndërballkanike dhe shqiptarët në shek. XVI-XVII”*, tema përbëhet nga: 5 kapituj, nga parathënia, hyrja, metodologjia e trajtimit të temës, përmbajtja e trajtuar në temë, përkufizimi kohor i temës, burimet dhe literatura dhe nga nocioni gjeografik dhe politik i Ballkanit dhe shqiptarët. *Në kapitullin e parë trajtohet Ballkani në sundimin e Perandorisë Osmane në shek. XVI, ku në mënyrë të hollësishme përshkruhet gjendja e*

popujve të Ballkanit, rritja e lëvizjeve çlirimtare e popujve të Ballkanit, kryengritjet me karakter çlirimtar dhe rëndësia ndërkombëtare e tyre, ekspedita ushtarake e Sulltan Sulejmanit II në Himarë dhe rritja e luftës së koalicionit evropian dhe shqiptarët në shek. XVI. Në brendinë e kapitullit të parë është trajtuar se si Perandoria Osmane gjatë shek. XVI dhe XVII përdori metoda të llojllojshme për shkombëtarizimin dhe asimilimin e plotë të popujve të Ballkanit. Por, popujt e Ballkanit e ruajtën gjuhën, që ishte element shumë i rëndësishëm në ruajtjen dhe kultivimin e identitetit të tyre kombëtar. Në krahasim me popujt e tjerë të Ballkanit, popullit shqiptar asnjëherë nuk u lejua nga Perandoria Osmane hapja e shkollave në gjuhën e tyre amtare. Ata dëshironin që me çdo kusht asimilimin e shqiptarëve dhe humbjen e identitetit të tyre. Në gjysmën e dytë të shek. XVI shtetet evropiane filluan të kundërshtonin me vendosmëri ekspansionin e ushtrisë osmane. Por, kundërshtarët e Perandorisë Osmane nuk ishin të vendosur, dhe aq të fortë që të bënin luftë të fuqishme. Osmanët asnjëherë nuk hiqnin dorë nga ideja e pushtimit të Evropës Qendrore. Kjo bëri që shtetet evropiane të marrin me seriozitet pretendimet osmane. *Në kapitullin e dytë trajtohen projektet e himarjotëve drejtuar Romës; Kontaktet e himarjotëve me Romën; Politika e Romës ndaj himarjotëve; Kërkesat e himarjotëve drejtuar Romës në vitin 1578; Letra e parë drejtuar Grigorit XIII; Letra drejtuar peshkopit Hydrugeto De Capua; Letra e parë drejtuar kardinalit GulielmSirleto; Letra e dytë dërguar Grigorit XIII; Letra e dytë drejtuar peshkopit Hydrugeto De Capua; Letra e dytë drejtuar kardinalit GulielmSirleto; Letra e himarjotëve dërguar Grigorit XIII, në projekte të përbashkëta kundër Perandorisë Osmanëve; Përgjigjja e Grigorit XIII ndaj letrës së himarjotëve.* Në raport me krahinat tjera, himarjotët ishin më përpara në ngritjen e vetëdijes kombëtare sepse edhe para periudhë së Skënderbeut ishin larguar nga atdheu i tyre dhe kishin emigruar në Itali, ku patën mundësinë të shkolloheshin, dhe dijen e tyre u munduan të sjellin në vendin e origjinës së tyre në Shqipëri dhe veçanërisht në krahinën e Himarës. Kjo ishte njëra ndër shumë arsye të ngritjes së vetëdijes kombëtare të himarjotëve për të luftuar për çlirimin e vendit të tyre ndaj pushtuesve osman. Popullsia shqiptare që banonte në trevat e qëndresës që nga Himara e deri në Dukagjin u ngritën dhe mbështeten me gjithë potencialin e tyre projektet e shteteve evropiane, duke shpresuar se ishte koha e favorshme të dëbohej njëherë e përgjithmonë pushtuesi osman nga trevat shqiptare. *Në kapitullin e tretë, bëhet fjalë për projektet dhe kuvendet shqiptare në fund të shek. XVI dhe në fillim të shek. XVII; Projekti i MarkSamuelit për veprime të përbashkëta në Shqipëri; Projekti i Aleksandër Komuloviç për çlirimin e Ballkanit; Lufta e Klishit dhe*

pjesëmarrja e shqiptarëve 1596; Kuvendi i Matit 1595; Kuvendi i Blinishtit 1598; Kuvendi i Dukagjini 1602; Projektet e ballkanasve drejtuar kancelarive evropiane; Projekti i NikollëMekajshin për çlirimin e Shqipërisë 1610; Bashkimi i maleve shqiptare. Në kapitullin e tretë në mënyrë të detajuar është parashtruar organizimi i kryengritjeve të armatosura, bashkimi i forcave që solli bashkëpunimin midis kuvendeve të fiseve fqinje. Fillimisht ishte një numër i vogël fisesh, por me kalimin e kohës numri i fiseve u shtua dhe u bashkuan. Për t'i zgjidhur problemet e përbashkëta politike, fiset e bashkuara organizuan kuvendet e përbashkëta ku merrnin pjesë krerët, udhëheqësit ushtarakë dhe përfaqësues të tjerë të secilit fisi. Edhe pse projektet e kuvendeve shqiptare nuk gjetën mbështetje nga shtetet e Evropës Perëndimore, ballkanasit nuk i ndalen përpjekjet e tyre pranë kancelarive evropiane, për t'i realizuar përpjekjet e tyre për çlirimin e Ballkanit. *Në kapitullin e katërt trajtohen kuvendet ndërballkanikë në shek. XVII; Kuvendi i Moraçës 1608; Kuvendet ndërballkanike të Kuçit 1614; Relacioni mbi përбетimin e bërë në Kuvendin e Kuçit; Kuvendi ndërballkanik i Prokupjes 1616; Kuvendi ndërballkanik i Beogradit 1620.* Kuvendet shqiptare dhe ndërballkanike nuk kishin të bëjnë me vështrimin e ngushtë të organizimit fisnor, por kishin karakter më të gjerë midis krerëve të krahinave të ndryshme që bashkoheshin në momente të vështira për të luftuar në rast të rreziku të madh që u vihej. Kuvendet gjatë asaj kohe morën një vështrim ndër fisnor dhe përfaqësonin fazën e parë të një bashkimi politik në mes të zonave, të cilat do bashkoheshin dhe përforcoheshin në rast të sukseseve të tyre. Bashkimi i tyre do ishte në fuqi për sa kohë do të merreshin vendime, shtroheshin projekte dhe pritej koha e volitshme për të filluar luftën. Kishte edhe raste me të avancuara të bashkimit ndër krahinor, kur kuvendi i përbashkët caktonte kryetarin e përhershëm, i cili në rast nevojë lidhte i pari marrëveshje me krerët e tjerë kryesorë ose me përfaqësuesit e princave të Evropës. Lëvizjet e armatosura dhe bashkimi i kuvendeve fisnore, ngritën moralin dhe vetëdijen njerëzore se vetëm me bashkimin e vendeve të Ballkanit mund të realizohen projektet e shtruara në kuvendet ndërballkanike për të filluar luftën e përbashkët për largimin e osmanëve nga Ballkani. Në mënyrë të detajuar, Kuvendi kishte planifikuar të fillonte ndërmarrjen ushtarake për çlirimin e vendeve ballkanike dhe më gjerë, por projektet e nxjerra nga kuvendi nuk gjetën mbështetjen e duhur nga shtetet e Evropës. Projektet mbeten vetëm në letër dhe nuk u realizuan në praktikë. Edhe pse kuvendet nuk e dërgonin deri në fundin planin e tyre, kishte rëndësi të madhe në afrimin e krerëve dhe të klerikëve të popujve të Ballkanit që të bashkoheshin në luftën e përbashkët kundër Perandorisë Osmane. Sikur të gjenin mbështetjen nga

shtetet e perëndimit, projektet e popujve të Ballkanit do të realizoheshin me sukses. *Ndërsa në kapitullin e pestë trajtohen, projektet gjatë kuvendeve ndërballkanike dhe kryengritjet gjatë shek. XVII; Projektet i Athanasit 1615-1616; Projektet e Sulltan Jahjait; Projektet e PjetërBudrit 1615-1621; Projektet i mbretit francez Gjon Kler 1618; Politika e Vatikanit ndaj shqiptarëve në gjysmën e parë të shek. XVII; Shqiptarët gjatë luftërave evropiane kundër osmanëve 1644-1699; Kryengritjet e kelmendasëve; Kuvendi i Gradecit dhe kryengritjet 1688-1689; Shqiptarët dhe luftërat austro-osmane 1683-1699.* Lufta e shenjtë kundër pushtimeve osmane mori karakterin e një lufte çlirimtare të popujve të krishterë të Perandorisë, por në fakt mbeti një përpjekje e madhe që bëri Vatikanin për të rifituar pozitat e humbura dhe për të vendosur sundimin kishtar. Vatikanin në këtë mënyrë mbajti në tension shtetet katolike të Evropës. Populli shqiptar edhe kësaj radhe shikohej të ishte primar për interesat e Vatikanit në Ballkan. Perandoria Osmane në mesin e shek. XVII kishte arritur nivel të lartë politik dhe ushtarak. Gjendja e brendshme e shqiptarëve në të gjitha pikëpamjet ishte e rëndë. Ushtria osmane kishte arritur suksese të mëdha, ajo sillte ndaj kombeve të shtypura të Perandorisë në mënyrën më arrogante të mundshme. Ushtria osmane mbi krahinat malore merrte masa të vazhdueshme. Nën presionin e persekutimeve politike dhe ideologjike, gati dy të tretat e popullsisë shqiptare ishin konvertuar në fenë islame. Marrëdhëniet ndërkombëtare i shkonin përshtati Perandorisë Osmane, sepse shtetet evropiane ishin të përfshirë në Luftën Tridhjetëvjeçare. Nga të gjitha shtetet ballkanike të Mesdheut, populli shqiptar dhe malazez bëri një qëndresë me të vendosur dhe më të madhe kundër sundesve osman. Një bashkëpunim më i ngushtë i fiseve të Malit të Zi dhe të shqiptarëve të Veriut ishte në fillim të shek. XVII. Sepse vetëm me bashkimin e popujve të Ballkanit, duke luftuar kundër armikut të përbetuar mund të realizonin lirinë e tyre. Kuvendet ndërballkanike i propozuan shteteve të Evropës Perëndimore projektet konkrete për të bashkëpunuar në luftën kundër Perandorisë Osmane, çdo herë duke u mbështetur në forcat e tyre dhe në traditën shekullore të lëvizjeve të armatosura çlirimtare. Në rrethana të tilla krerët shqiptarë më dëshirën më të madhe për ta çuar përpara luftën çlirimtare kërkonin të arrihej bashkim i popujve të Ballkanit, që tashmë ndjehej më shumë se sa më parë. Filluan të zhvilloheshin takime dhe të arriheshin marrëveshje mes krerëve dhe popujve të Ballkanit. Me gjithë pengesat që ekzistonin dhe që mund të hasnin gjatë rrugëtimit të tyre, përpjekjet për bashkimin e lëvizjeve çlirimtare në Ballkan u çuan përpara.

Marrëdhëniet midis popujve të Ballkanit që nga pushtimet e para osmane në Ballkan kanë kaluar nëpër periudha të ndryshme, të cilat kanë lënë gjurmë dhe njëfarë mënyre kanë ndikuar në marrëdhëniet e tyre në luftën e përbashkët kundër pushtuesve osmanë. Shqiptarët dhe popujt fqinjë të Ballkanit që jetonin me shekuj pranë njëri-tjetrit ka ndikuar në shumë veprime të përbashkëta për t'i arritur qëllimet e tyre. Shqiptarët ka fundi i shek. XVI dhe gjatë shek. XVII u bashkuan si asnjëherë më parë me të gjitha forcat e brendshme, në bashkëpunimin dhe afrimin edhe me popujt e tjerë të Ballkanit, dhe në koordinim më këta të fundit për të kërkuar ndihmë edhe nga shtetet e tjera evropiane.

Ballkanasit ishin të shtyrë dhe të përkrahur nga vendet evropiane në projektet e tyre çlirimtare. Në vazhdim po i përmendim kancelaritë evropiane veçanërisht Spanjën, Vatikanin, Mbretërinë e Napolit dhe shumë princa tjerë. Këto vende në mënyrë të drejtpërdrejt apo tërthorazi e mbajtën çdo herë të ndezur luftën në trevat shqiptare dhe ballkanike. Shtete evropiane, në veçanti Spanja, me gjithë interesimin e shprehur për t'i përkrah projektet e vendeve ballkanike, ato asnjëherë nuk u realizuan në praktik përveçse premtimeve të shumta së do vihej koha e duhur kur do të ndërmerren aksione të përbashkëta për dëbimin e Perandorisë Osmane nga Ballkani. Shqiptarët asnjëherë nuk e humbën shpresën të faktori ndërkombëtar që një ditë do t'u vihet ndihma e shumë pritur nga Perëndimi. Projektet e ballkanasve u përkrahën edhe nga Franca, veçanërisht në dhjetëvjetorin e dytë të shek. XVII, kur duka i Neversit bëri përpjekje maksimale për t'i përkrahur projektet. Po ashtu, edhe austriakët nuk qëndruan indiferent dhe i përkrahen projektet e dala nga kuvendet ndërballkanike, përmes lidhjeve të boshnjakëve që krijuan me shqiptarët dhe popujt e tjerë të Ballkanit.

Një element tjetër i rëndësishëm së pse shqiptarët u bënë faktorë në organizimin e luftës në Ballkan ishte, se vendet sllave e ruajtën në njëfarë mënyre vasalitetin ndaj Perandorisë Osmane në Ballkan. Kjo bëri që popujt sllavë nuk ishin aktiv çdo herë në kryengritje kundër sunduesve osmanë. Në dekadën e fundit të shek. XVI dhe në fillim të shek. XVII, rezistenca e popullit shqiptar dhe popujve tjerë të Ballkanit, kaloi në një nivel më të lartë të organizimit politik dhe ushtarak. Në këto rrethana uniteti shqiptar filloi të forcohej, duke filluar kontaktet e bashkëpunimit me shtetet perëndimore. Kuvendet shqiptare paraqesin veten si të barabartë me shtetet perëndimore, me princat, me mbretërit, filluan të zhvilloheshin kontaktet vetëm përmes marrëveshjeve dypalëshe, por, jo edhe në nivelin më të lartë me nënshkrimin e diktatit. Kuvendet shqiptare me vendimet e marra synonin të koordinonin veprimet e tyre për një luftë të organizuar

dhe të përbashkët, për dëbimin e ushtrisë osmane nga tokat shqiptare dhe përgjithësisht nga Ballkani. Nga kuvendet ndërballkanike dolën projekte konkrete se si duhej zhvilluar lufta çlirimtare për dëbimin e ushtrisë osmane nga Ballkani. Popujt e Ballkanit e shikonin si të drejt të tyre t'u drejtoheshin kancelarive evropiane për të kërkuar armë dhe ushtri, sepse ishin të ndërgjegjshëm për kontributin në mbrojtjen e tokave të tyre. Shqiptarët dhanë kontribut të jashtëzakonshëm në kauzën e madhe ballkanike dhe evropiane. Kuvendet, projektet dhe lufta e shqiptarëve gjatë asaj kohe qëndroi në qendër të vëmendjes së kancelarive evropiane. Shqiptarët ishin faktorë kryesorë dhe zunë vend të rëndësishëm në kuvendet e përbashkëta ndërballkanike me malazezët, boshnjakët, hercegovinasit, serbët dhe bullgarët për interesat e tyre të përbashkëta.